



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr.134, datë 30.09.2020

“PËR

KRIJIMIN E SHOQËRISË “TIRANA DC” SH.A, SI PERSON JURIDIK NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË DHE MIRATIMIN E AKTEVE TË THEMELIMIT”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b”, pika 1.4 dhe pika 1.6, shkronja “b”, nenit 33, pika 1, shkronja “d”, nenit 54, shkronja "d" dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Krijimin e shoqërisë tregtare “Tirana DC” sha, në formën e shoqërisë aksionare, me objekt kryesor të veprimtarisë së saj projektimin, rindërtimin, ndërtim, zbatim, kolaudim të ndërtimeve të të gjitha llojeve.
2. Qëllimi i shoqërisë “Tirana DC” sh.a është vënia në përdorim më eficientë të pasurive të paluajtshme të transferuara tek shoqëria, me objektiv nxitjen e zhvillimit ekonomik nëpërmjet projekteve të investimit me kapital shtetëror dhe/ose në bashkëpunimit me sektorin privat vendas apo të huaj.
3. Bashkia Tiranë është aksionari i vetëm themelues, i cili zotëron 100 (njëqind) % të kapitalit themeltar të shoqërisë “Tirana DC” sh.a.
4. Miratimin e aktit të themelimit dhe statutit të shoqërisë “Tirana DC” sh.a, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
5. Shoqëria “Tirana DC” sh.a themelohet, organizohet dhe funksionon si shoqëri aksionare në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.
6. Kapitali fillestar për krijimin e shoqërisë “Tirana DC” sh.a., të jetë 50,000,000 (pesëdhjetë milionë) lekë, i ndarë në 1,000 aksione, me një vlerë nominale prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë secili.
7. Shoqëria mund të financohet nga Bashkia Tiranë dhe të ardhura të tjera të lejuara nga legjislacioni në fuqi.
8. Shoqëria “Tirana DC”sh.a në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj, ka të drejtë të shqyrtojë dhe të vlerësojë mundësinë e bashkëpunimit me shoqëri të tjera tregtare apo të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me persona të tjerë fizikë dhe/ose juridikë, publikë dhe/ose privatë, vendas dhe/ose të huaj.
9. Shoqëria “Tirana DC” sh.a, fillimisht ka selinë qendrore në adresën Sheshi “Skënderbej”, Ndërtesa 2, 1001, Tiranë, Shqipëri.
10. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë për përgatitjen dhe nënshkrimin e akteve të themelimit të shoqërisë, si dhe regjistrimin e saj sipas legjislacionit në fuqi.

11. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij që të përfaqësojë Bashkinë Tiranë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë “Tirana DC” sh.a, me përjashtim të rasteve kur në statutin e shoqërisë përcaktohet ndryshe.

12. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për krijimin e kapitalit fillestar të shoqërisë, përballohen nga buxheti i vitit 2020 dhe Bashkia Tiranë transferon këtë shumë pranë kësaj shoqërie, menjëherë pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

13. Ngarkohen kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.

14.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R I

TONI GOGU